



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:011108

Datë: 15.07.2024

Numri i dokumentit: 05941237

CA.nr.7099/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtaret Hidajete Gashi Alaj, kryetare e kolegjit, Enes Mehmeti dhe Hunaida Pasuli, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses/propozueses R.A në Prishtinë, e përfaqësuar sipas autorizimit nga A.J, avokat nga Prishtina, kundër të paditurit/kundërshtarit të sigurimit E.A nga Prishtina, i përfaqësuar sipas autorizimit F.SH, avokat në Prishtinë, me objekt të kontestit pjesëtimi i pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, me propozim për caktimin e masës së sigurisë, duke vendosur sipas ankesës së paditëses/propozueses së masës së sigurimit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.183/2022, i datës 21.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 11.07.2024 mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e paditëses/propozueses R.A nga Prishtina,, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.183/2022, i datës 21.05.2024, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e atakuar, C.nr.183/2022 të datës 21.05.2024, në dispozitiv të aktvendimit ka vendosur si në vijim:

*I.REFUZOHET i pabazuar propozimi për caktimin e masës së sigurisë së paditëses/propozueses R.A nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të “Caktohet masa e sigurisë në njësinë kadastrale me sipërfaqe të përgjithshme prej 319 m2, me numër P-...-6, e cila gjendet në vendin e quajtur*

.... Lagja ..., Zona Kadastrale Preoc, Komuna e Graçanicës, ashtu që i ndalohet të paditurit/kundërshtarit të sigurimit E.A nga Prishtina, që të ndërmerr çfarëdo veprimi me të cilin do të fshehë, ngarkoj apo tjetërsoj tek ndonjë palë e tretë, paluajtshmërinë e përshkuar si më lart, deri në një vendim tjetër të gjykatës.

II.Paditëses/propozueses pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, do t'i kthehen mjetet e deponuara në emër të garancionit në llogarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në shumën prej 2,000.00 €.”

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor përmes të autorizuarit të saj ankesë ka paraqitur paditësja/propozuesja e masës së sigurimit për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e parashtruar nga propozuesja R.A si të bazuar, ashtu që ta anulojë aktvendimin e atakuar, ashtu që të ndryshojë të njëjtin në favor të pretendimeve ankimore.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i padituri/kundërshtari i sigurimit, me propozim që Gjykata e Apelit ta refuzojë ankesën e paditëses si të pabazuar dhe aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë ta vërtetojë si të bazuar.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194, 208 dhe 209 të LPK-së gjeti se:

-Ankesa e paditëses/propozueses së masës së sigurisë është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësja/propozuesja e masës së sigurimit ka ushtruar padi me datë me datë 20.01.2022, me kërkesë për pjesëtimin e pasurisë së përbashkët të bashkëshortëve, së bashku me propozim për caktimin e masës së sigurimit, kundër të paditurit/kundërshtarit të sigurimit E.A nga Prishtina.

Paditësja/propozuesja në propozimin për caktimin e masës së sigurisë, ka kërkuar nga Gjykata që të caktohet masa e sigurimit, ndaj të kundërshtarit të sigurimit, ashtu që t'i ndalohet kundërshtarit të sigurimit E.A, tjetërsimi apo shitja, ngarkimi me hipotekë apo ndonjë barrë tjetër, të paluajtshmërive me numër P-...-6, me sipërfaqe prej 319 m<sup>2</sup>, në vendin e quajtur ..., që gjendet në Lagjen ..., Zona Kadastrale Preoc, Komuna e Graçanicës, si dhe paluajtshmërisë – banesës, që gjendet në Zonën Kadastrale ..., ngastra kadastrale me numër 27/8, Kompleksi ... SH.P.K., Blloku Urbanistik A21, Objekti 2, Njësia banesore numër 3. Kati i parë, me sipërfaqe prej 96 m<sup>2</sup>.

Gjykata e shkallës së parë fillimisht me aktvendimin C.nr.183/22 të datës 14.02.2024 e kishte Aprovuar pjesërisht si të bazuar propozimin për caktimin e masës së sigurisë së paditëses/propozueses R.A nga Prishtina dhe kishte caktuar masën e sigurisë në njësinë kadastrale me sipërfaqe të përgjithshme prej 319 m<sup>2</sup>, me numër P-...-6, e cila gjendet në vendin e quajtur ..., Lagjja ..., Zona Kadastrale Preoc, Komuna e Graçanicës, ashtu që i kishte ndaluar të paditurit/kundërshtari i sigurimit E.A, nga Prishtina, që të ndërmerr çfarëdo veprimi me të

cilin do të fshehë, ngarkoj apo tjetërsoj tek ndonjë palë e tretë, paluajtshmërinë e përcaktuar si më lartë, deri në një vendim tjetër të gjykatës. Ndërsa e kishte refuzuar propozimin e paditëses/propozuesies për caktimin e masës së sigurisë në paluajtshmëritë, me të cilën ka kërkuar që të “Caktohet masa e sigurisë ashtu që të i ndalohej të paditurit/kundërshtari i sigurimit E.A, nga Prishtina, që të ndërmeret çfarëdo veprimi me të cilin do të fshehë, ngarkoj apo tjetërsoj tek ndonjë palë e tretë, paluajtshmërinë – banesën që gjendet në Zonën Kadastrale në ..., ngastrën kadastrale me numër 27/8, Kompleksi ... SH.P.K, Blloku Urbanistik A21, Objekti 2, Njësia banesore me numër 3, me sipërfaqe të përgjithshme prej 96 m<sup>2</sup>, si i pabazuar.

Gjykata e Apelit të Kosovës duke vendosur sipas ankesës së të paditurit kundërshtarit të sigurimit me Aktvendimin CA.nr.3022/2024 të datës 22.03.2024, e kishte Aprovuar të themeltë ankesën e të paditurit/kundërshtarit të sigurimit E.A nga Prishtina dhe ka anuluar pikën I, II dhe IV e dispozitivit të aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, C.nr.183/22, i datës 14.02.2024, dhe çështjen e ka kthyer në procedim të serishëm dhe rivendosje. Ndërsa pikën III të dispozitivit të aktvendimit për pjesën e refuzuar të propozimit për caktimin e masës së sigurisë, e kishte lënë të pashqyrtuar.

Gjykata e shkallës së parë pas mbajtjes së seancës dëgjimore, me aktvendimin C.nr.183/2022 të datës 21.05.2024 e ka refuzuar si të pa bazuar propozimin e paditëses/propozueses së masës së sigurimit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktvendimit të atakuar ka theksuar se, ka shqyrtuar me kujdes propozimin për masës së sigurisë si dhe deklaratimet e palëve ndërgjyqëse lidhur me caktimin e masës së sigurisë në seancën dëgjimore dhe pas analizimit të provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata ka ardhur në përfundim se propozimi i palës paditëse/propozuese për caktimin e masës së sigurimit, është i pa bazuar.

Me nenin 297 të LPK-së, është paraparë se *“Masa e sigurimit mund të caktohet në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të drejtë subjektive të tij, dhe në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së tillë, pala kundërshtarë do të mund të pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet, me fshehjen e saj, me ngarkim apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*. Po ashtu, me nenin 300 të LPK-së është paraparë se për sigurimin e kërkesës së drejtuar kah sendi i caktuar apo kah një pjesë e tij mund të caktohen disa lloje të masave të sigurisë, ndërsa me nenin 304 paragrafi 3 të LPK-së përcaktohet, mes tjerash, se *“Propozuesi në propozimin e tij duhet të tregoj edhe faktet mbi të cilat mbështetet kërkesa e tij, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim”, si dhe që “mjetet provuese t’ia bashkëngjisë propozimit”*.

Me tutje ka theksuar se, në rastin konkret nuk janë plotësuar kumulativisht kushtet e parapara me dispozitat e sipërcituara ligjore për caktimin e masës së sigurimit. Kjo për faktin se në rastin konkret edhe në rast se propozuesi i sigurimit do ta bënte të besueshme të drejtën e tij subjektive mbi objektin e kontestit, i njëjti gjykatës nuk i ka ofruar prova se kundërshtari i sigurimit ka

ndërmarrë ndonjë veprim për tjetërsimin apo ngarkimin me ndonjë barrë reale të paluajtshmërisë lëndore apo edhe se i njëjti është në situatë të pavolitshme financiare, e mbi bazën e të cilave veprime pastaj gjykata do të kishte mundësi që të vlerësonte ndryshe edhe kushtin e dytë ligjor të kërkuar sipas dispozitës së nenit 297 paragrafi 1 pika b) të LPK-së, që i referohet rrezikut lidhur me dëmin eventual që mund t'i shkaktohej propozuesit të sigurimit si shkak i mos caktimit të masës së propozuar, përkatësisht e njëjta nuk e ka argumentuar me ndonjë provë ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së sigurisë do t'i pamundësohej apo vështirësohej dukshëm realizimi i kërkesës. Kjo për faktin se paluajtshmëria kontestuese, mbi të cilën pala propozuese ka kërkuar që të vendoset masë e sigurisë, sipas Marrëveshjes mbi Themelimin e Hipotekës, me numër identifikues LRP.nr.3086/2015 dhe me numër të referencës 1058/2015, e datës 13.11.2015, e lidhur në mes të Raiffaisen Bank Kosovo J.S.C. dhe palëve ndërgjyqëse, palët në fjalë janë pajtuar që në emër të kredisë së marrë të vihet në hipotekë paluajtshmëria me numër të ngastrës kadastrale P-...-6, Zona Kadastrale Preoc, Komuna e Graçanicës, me sipërfaqe prej 311 m<sup>2</sup>, pronë kjo e regjistruar në emër të kundërshtarit të sigurimit E.A, e që është pikërisht paluajtshmëria kontestuese. Po ashtu, nga certifikata për të drejtat pronësore lidhur me këtë paluajtshmëri e datë 07.12.2023, konstatohet fakti i regjistrimit të kësaj hipoteke. Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se paluajtshmëria në fjalë, në tërësinë e saj, vetëm se ka ndalesë (barrë sendore – hipotekë) nga subjektet e tjera dhe rrjedhimisht nuk ka ndonjë rrezik mbi bazën e të cilit do të vështirësohej apo i pamundësohej propozueses realizimi i të kërkesës së saj. Andaj, gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke refuzuar propozimin e palës paditëse/propozuese për caktimin e masës së sigurisë.

Bazuar në arsyet e cekur më lartë, gjykata refuzoi propozimin e paditëses/propozuesit, për caktimin e masës së sigurimit, pasi vlerësoi se nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara në dispozitivin ligjor të nenit 297 paragrafi 1 pika a) dhe b) të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 297, neni 300 paragrafi 1 pika a) dhe lidhur me nenin 142 paragrafi 5 të LPK-së, kjo gjykatë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata e Apelit e pranon vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për të cilat Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të autorizuarit të propozueses të masës së sigurimit se aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pika n) të LPK-së, sepse dispozitivi i aktvendimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktvendimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate dispozitivi i aktvendimit është i qartë

dhe përmban të gjitha arsyet për faktet vendimtare si dhe arsyet e paraqitura janë të qarta dhe bindëse për mënyrën e vendosjes në këtë rast.

Gjykata e Apelit e ka pranuar në tërësi përfundimin e gjykatës së shkallës së parë se, në këtë rast nuk janë plotësuar kushtet për caktimin e masës së sigurimit, të parapara me dispozitat e nenit 297 të LPK-së, paragrafi 1 pika a) dhe b), pra kushtet të cilat duhet të plotësohen kumulativisht në mënyrë që gjykata të caktoj masën e sigurimit.

Si kushte që rrjedhin nga dispozitat e cituara janë besueshmëria e ekzistimit të kërkesës apo të drejtës subjektive dhe rreziku se pa caktimin e masës së sigurimit do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës.

Me dispozitën e nenit 297.1 pika a) të LPK-së parashihet që: *“Masa e sigurimit mund të caktohet: a) në qoftë se propozuesi i sigurimit e bënë të besueshme ekzistimin e kërkesës apo të së drejtës subjektive të tij”*, andaj, në rastin konkret propozimi i paditëses/propozueses të masës së sigurimit tani për tani është i pabazuar, sepse propozuesja nuk ka ofruar prova të mjaftueshme për të vërtetuar faktin se në mënyrë kumulative janë plotësuar kriteret e përcaktuara me nenin 297 të LPK-së, pra edhe pse pala propozuese deri diku e ka bërë të besueshme ekzistimin e të drejtës subjektive e njëjta nuk ka ofruar prova për ekzistimin e rrezikut se pa caktimin e masës së këtillë do të pamundësohej apo vështirësohej dukshëm realizimi i kërkesës së propozueses, apo rreziku i tjetërsimit, fshehjes, ngarkimi me ndonjë barrë apo ndryshimi i gjendjes ekzistuese. Pra në këtë rast nuk është plotësuar kushti i rrezikut se pa caktimin e masës do të pamundësohet apo vështirësohet dukshëm realizimi i kërkesës.

Gjykata e Apelit vlerëson sene rastin konkret nuk ekzistojnë shkaqet nga pika b) e nenit të sipërcituar i cili parasheh që: *“Në qoftë se ekziston rreziku se pa caktimin e masës së këtillë pala kundërshtare do të mund ta pamundësonte apo vështirësonte dukshëm realizimin e kërkesës, sidomos me tjetërsimin e pasurisë së vet. Me fshehjen e saj, me ngarkimin apo me ndonjë mënyrë tjetër, me të cilën do ta ndryshonte gjendjen ekzistuese të gjërave, ose në ndonjë mënyrë tjetër do të ndikonte negativisht në të drejtat e propozuesit të sigurimit”*, kjo për arsye se ashtu siç ka konstatuar edhe gjykata e shkallës së parë, paditësja – propozuesja me asnjë provë të vetme nuk e ka bërë të besueshme se ekziston rreziku i shitjes, tjetërsimit apo në çfarëdo forme e kundërshtari i sigurimit/i padituri do të rrezikonte – vështirësonte apo pamundësonte realizimin e të drejtës subjektive të paditëses dhe se thëniet e palës paditëse se i padituri dëshiron të bëjë tjetërsimin e pasurisë së huaj, më qëllim të ndryshimit të gjendjes në teren të pronës së paluajtshme, mbeten vetëm në kuadrin e pretendimeve, por që të njëjtat nuk janë të mbështetura në as edhe një provë të vetme që do të vërtetonte faktin e tillë.

Vendimi për masë të sigurisë është vendim përmes të cilit sigurohet ruajtja e gjendjes ekzistuese, nga ndryshimi eventual që mund ta ndryshoj një gjendje të tillë, dhe se aprovimi apo refuzimi i një propozimi për caktim të masës së sigurimit nuk nënkupton aprovimin apo refuzimin e kërkesëpadisë.

Pra, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur e ka refuzuar propozimin e paditëses/propozueses të masës së sigurimit, dhe gjykata në procedurën e masës së sigurimit nuk lëshohet në themelësinë – bazueshmërinë e provave dhe argumentimit të

tyre në raport me kërkesëpadinë, por vlerësimi i tyre është vetëm në kuptim të plotësisimit të kushteve të caktimit të masës.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e tjera ankimore, por të njëjtat ishin pa ndikim për një vendosjes ndryshe nga ajo që është vendos në dispozitivi të këtij aktvendimi.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 208 dhe 209 pika b) të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË  
CA.nr.7099/2024, datë 11.07.2024

Kryetare e kolegjit  
Hidajete Gashi Alaj, d.v.